•€€€€€€€€ Per kete arsye, eshte teresisht i pabazuar ne ligj pretendimi i Paditesit se Bordi i Apelimit duhet te pranonte automatikisht ankimin e iij per aq kohe sa pala kundershtare nuk ka paraqitur argumentet e saj. Pra, eshte njesoj si t'i kerkohet Gjykatave te Apelit qe te pranojne automatikisht ankimet ndaj vendimeve te Gjykatave te Shkallave te Para per shkak se pala tjeter nuk ka paraqitur kunder-ankim apo pretendimet e saj.
•€€€€€€€€ Duke mos dashur te aludojme mbi shkaqet e nxjerrjes se vendimit te pezullimit nr. 70/16, date te Bordit te Apelit te DPPI-se dhe duke rezervuar te drejten per te mos u shprehur mbi gdo analize tjeterte karakterit jo-ligjor, jemi te mendimit se ky akt administrativ eshte marre ne zbatim dhe interpretim te gabuar te ligjit material per arsyet qe po parashtrojme me poshte:
Se pari, Bordi i Apelit i DPPI-se gabon rende rie arsyetimin e vendimit te tij duke percaktuar se objekti i shqyrtirnit ne kete procedim administrativ eshte te percaktoje se ciles nga palet pretenduese i takojne te drejtat e meparshme mbi markat{...}[AL-T-2017-70],{...}[AL-T-2017-71] dhe {...}[AL-T-2017-525].
•€€€€€€€€ Interpretimi i mesiperm i Bordit te Apelit eshte teresisht i pavertete, i pasakte dhe i pabazuar ne dispozitat materiale dhe proceduriale te ligjit nr. 9947/2008. Objekt i shqyrtimit administrativ te Bordit te Apelit nuk eshte dhe nuk ka se si te jete kurresesi qe te percaktoie se cila nqa palet gezon te dreita te meparshme mbi markat e siperpermendura, por eshte vetem qe te shqyrtoie dhe marre nie vendim ne lidhie me reqjistrimin apo refuzimin e markave{...}IAL-T-2017- 701,{...}fAL-T-2017-711 dhe "BATQ The Illyrian King" fAL-T-2017-5251 bazuar ne faktet e niohura liqjerisht ne momentin e nxierrjes se aktit administrativ.
•€€€€€€€€ Ne kete kuptim, te dreitat e prioritetit te shoqerise {...}mbi markat e sai{...}dhe {...} iane vleresuar dhe niohur ligjerisht nqa Sektori i Ekzaminimit te Markave ne momentin e depozitimit te kerkesave per reqjistrim marke dhe nuk mund te qjykohen nqa Bordi i Apelit qjate procedurave administrative me objekt te ndryshem. Pra, e thene ndryshe, te drejtat e prioritetit te markave {...} dhe{...}te Personit te trete jane miratuar nepermjet nxjerrjes se akteve administrative te veganta qe nuk jane objekt i gjykimit administrativ per kundershtim regjistrim marke prane Bordit te Apelit.
•€€€€€€€€ Bordi i Apelit ka kompetence liqjore per te qjykuar dhe shqyrtuar vetem liqjshmerine e vendimit te Dhomes bazuar ne te dhenat liqjore dhe faktike te niohura te paleve ne momentin e nxjerrjes se aktit administrativ. Ne rast se do te veprohej ne menyre te kundert, do te gjendeshim perballe nje shkeljeje flagrante te ligjit dhe tejkalim absolut te kompetencave te Bordit te Apelit. Bordi i Apelit apo dhe vete gjykata nuk mund te shqyrtoje ligjshmerine e akteve administrative te tjera qe nuk jane objekt i gjykimit administrativ. •€€€€€€€€ Se dyti, sig u tha edhe me siper, eshte teresisht i paprauueshem konstatimi i Bordit te Apelit mbi pretendimet e shoqerise "Kantina e Pijeve Gjergj Kastrioti Skenderbeu" sh.a. per te drejtat e prioritetit ne lidhje rne markat e mesiperme.
Shoqeria "Kantina e Piieve Gjergj Kastrioti Skenderbeu" nuk pretendon te drejta prioriteti mbi markat {...} dhe "DORUNTINA", pasi te drejta te tilla iane njohur dhe vleresuar tashme zyrtarisht e liqjerisht nga Sektori i Ekzaminimit te Markave ne kuader te procedurave administrative perkatese.
•€€€€€€€€ Keto procedura nuk lidhen dhe jane teresisht te ndryshme nga procedurat dhe objekti i shqyrtimit administrativ ne Bordin e Apelit, te cilat lidhen me ligjshmerine e vendimit te Dhomes Per Shqyrtimin e Kundershtimeve (aktin administrativ) vetem dhe ekskluzivisht mbi bazen e fakteve dhe te dhenave te njohura ligjerisht deri ne momentin e marrjes se vendimit.
•€€€€€€€€ Ne cdo rast, Bordi i Apelimit nuk ka asnie tager apo kornpetence liqjore qe te veje ne dvshim daten e prioritetit te markes se niohur nga Sektori i Ekzaminimit te Markave treqtare.Per me teper, sig u permend edhe me siper, Bordi i Apelimit nuk mund te vleresoje apo te shqyrtoje daten e prioritetit te nje marke ne kushtet kur gjendemi perpara procedures se kundershtimit te regjistrimit te nje marke tjeter (procedura administrative te ndryshme). Giate shqyrtimit te procedures se kundershtimit te nie marke, Bordi i Apelimit mbeshtetet vetern ne analizimin e anes formale dhe materiale te kundershtimit ndai reqjistrimit te markes se kontestuar.
•€€€€€€€€ Se treti, geshtja se ciles Bordi i Apelit I referohet si parakusht perzgjidhjen e procedurave ne shqyrtim, nuk lidhet me pretendimin per prioritet te shoqerise "Kantina e Pijeve" mbi marken {...}.Sig shpjeguam me siper, e drejta e prioritetit eshte niohur nga DPPI-ia dhe nuk eshte absolutisht objekt i geshtjes gjyqesore se ciles i referohet Bordi i Apelimit ne Vendimin nr, 70/16. Keshtu, sig mund te verifikohet edhe nga provat e paraqitura nga Paditesi. geshtja gjyqesorr e referuar gabimisht si parakusht nqa Bordi i Apelit. ka per

obiekt refuzimin e regjistrimit te markes “{...}’’ me numer kerkese AL-T-2016-934 te aplikuar nqa shoqeria{...}.
•€€€€€€€€ Pra, pavaresisht vendimit qe do te marre Gjykata Administrative e Apelit Tirane mbi geshtjen administative ne fiale (qofte refuzirni i regjistrimit te markes apo vijimi i procedurave te regjistrimit te markes se Paditesit), e drejta e prioritetit te markes {...} te Personit te trete do te mbetet e pandryshuar dhe e nieite me ate te njohur nga Sektori i Ekzaminimit te Markave gjate procedurave te aplikimit per regjistrim marke.
•€€€€€€€€ Si rrjedhoje, konkludojme lehtesisht se procedurat e kundershtimit te markave-objekt i Vendimit te pezullimit nr. 70/16, nuk kane asnje lidhje apo varesi direkte/indirekte me geshtjen gjyqesore te referuar nga Bordi i Apelit.
•€€€€€€€€ Per sa me siper, konstatoime qartesisht se referimi i kesai ceshtieje si parakusht per zqjidhien e procedurave administrative ne fiaie, eshte ne kundershtim dhe interpreting te qabuar te nenit 66 te liqjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative ne Republiken e Shqiperise.

Arsyetim ligjor

Shqyrtimi gjyqesor i veprimtarive qeveritare e ka origjinen e vet ne filozofine e shtetit qe qeveriset dhe kufizohet nga ligji dhe bazohet tek parimi i epersise se ligjit. Ne ditet e sotme, nje shtet ligjor nuk mund te mendohet pa akses per te gjithe qytetaret tek nje gjykate e pavarur dhe e paanshme, e themeluar ne baze te ligjit dhe e afte per te permbushur kerkesat e zhvillimit te nje gjykimi te drejte. Si i tille, roli i shqyrtimit gjyqesor i veprimtarise administrative eshte te mbroje te drejtat e qytetareve, por edhe te mbroje interesin publik dhe rendin ligjor. Krahas ketij roli mbrojtes, kontrolli gjyqesor shihet si nje mjet i rendesishem ne rritjen e cilesise se administrimit dhe qeverisjes se mire.
Qe nje rend qeverisjeje ne nje shoqeri te caktuar te realizoje me sukses zhvillimin shoqerise, duhet te kete nje aparat shteteror sa me te organizuar dhe efektiv. Ne nje shtet demokratik realizimi i funksioneve shteterore kerkon se pari nje organizim sa me te mire te aparatit shteteror dhe ne veganti te atij administrativ.
Organi administrativ ka detyrimin te vendose lidhur me geshtjet e parashtruara per tu zgjidhur perpara saj ne baze te nenit Neni 16 te Kodit te Procedurave Administrative:
*Parimi i marrjes se vendimeve*
*Ne perputhje me dispozitat e ketij Kodi, nje organ publik merr vendime per te gjitha geshtjet e ngritura nga nje pale, te cilat jane ne kompetence te tij.*
Gjithsesi ne raste te percakuara nga ligji organi administrative ka te drejte te pezulloje proceduren administrative nese vlereson se me pare duhet te zgjidhet ne nje geshtje tjeter qe perben parakusht.E drejta e organit administrativ per te pezulluar proceduren administrative eshte e parashikuar ne nenin 66 te Kodit te Procedurave Administrative I cili eshte I zbatueshem edhe nga pala e paditur.Pretendimet e pales paditese se Drejtoria e Pergjithshme e Pronesise Industriale nuk ka te drejte te vendose per pezullim te procedures jane ne kundershtim me Iigjin dhe konkretisht me Nenin 2 Fusha e zbatimit I cili parashikon se:
*“1. Ky Kod z{...}het kur organi publik, ne ushtrimin e funksioneve publike administrative, te rregulluara nga e drejta administrative:*
*a)* ***vendos per te drejtat, detyrimet dhe interesat e ligjshem te personave, si dhe gdo rast tjeter, kur ligji parashikon shprehimisht nxjerrjen e nje akti administrativ****;*
*b) lidh nje kontrate administrative apo kryen nje veprim tjeter administrativ, i cili ka te beje me te drejtat, detyrimet dhe interesat e ligjshem te personave."*
Jo vetem qe Kodi I procedurave Administrative eshte I zbatueshem nga Drejtoria e Pergjithshme e Pronesise Industriale por ai ka perparesi edhe ne raport me Ligjin e Posagem li Nr. 9947, date 7.7.2008, «Per Pronesine Industriale », I ndryshuar duke iu referuar hierarkise se ligjeve te percaktuara ne nenin 116 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise.
Gjithsesi qe organi te vendose pezullimin e procedures duhet te plotesohen kushtet e percaktuara nga Neni 66 Qeshtjet paraprake I Kodi te Procedurave Administrative:
“1. *Nese organi publik qe zhvillon proceduren perballet me nje geshtje, zgjidhja e se ciles eshte parakusht per zgjidhjen e procedures dhe qe perben nje geshtje ligjore te pavarur, per zgjidhjen e se ciles eshte kompetent nje gjykate ose organ tjeter ("geshtja paraprake"), organi publik qe zhvillon proceduren administrative pezullon proceduren deri ne marrjen e nje vendimi te formes se prere per geshtjen paraprake dhe njofton palen ne lidhje me kete.*
*2. Nese shqyrtimi i geshtjes paraprake mund te filloje vetem me kerkese te pales, organi kompetent per zhvillimin e procedures pezullon proceduren, duke njoftuar njekohesisht palen per te drejten qe ajo ka per te paraqitur kerkesen per geshtjen konkrete.*
*3. Nese zgjidhja e geshtjes paraprake kerkon iniciativen kryesisht te organit tjeter publik, organi kompetent per zhvillimin e procedures kerkon fillimin e procedures nga organi tjeter"*
Doktrina ka sqaruar se mund te kete raste kur nje geshtje eshte "paraprake" ne kuptimin e pikes 1, edhe pse zgjidhja e saj eshte ne kompetencen e te njejtit organ qe kryen proceduren ne vazhdim.Kjo mund te ndodhe, per shembull, kur i njejti organ eshte kompetent per te vendosur per geshtje juridikisht te ndryshme te pavarura sipas bazave te ndryshme ligjore dhe nje nga vendimet perben parakusht per marrjen e vendimit perfundimtar per proceduren ne vazhdim. Pra, kriteri vendimtar ne analize te fundit nuk eshte perfshirja e nje "gjykate apo organi tjeter" por kriteri "i pavarur" .
Qellimi i pikes 1, te nenit 66 eshte i dyfishte.
Nga njera ane, rregullimi eshte ne interesin publik per te shmangur aktivitetet procedurale te panevojshme te nje organi publik, domethene humbje kohe dhe burimesh, per sa kohe qe rezultati i procedures ne vazhdim eshte i pasigurt per shkak te varesise se saj nga rezultati i nje procedure tjeter/paraprake. Ne kete menyre, norma kontribuon ne zbatimin e parimit te eficences te percaktuar ne nenin 18.
Nga ana tjeter, kjo dispozite mbron interesin e pales, pasi vazhdimi i procedures mund te nderhyje ne te drejtat e veganta te pales perderisa geshtja paraprake nuk eshte zgjidhur.Pika 1, e nenit 36 dhe pjesa e dyte, e pikes 1, te nenit 93 jane dy raste te posagme dhe specifike te zbatimit te nenit 65.
Ne plotesim (ligji i pergjithshem ploteson ligjin e posagem) te ketyre rregullimeve te posagme,te parashikuara ne keto dy nene:
Pika 1, e nenit 66 parashikon rregullin e pergjithshem per te garantuar kete mbrojtjeve te paleve ne raste te ngjashme me interesa te krahasueshme.
Pikat 2 dhe 3, te nenit 66 plotesojne ratio legis (arsyen ligjore) te pikes 1. Ato synojne mbajtjen e periudhes se nderprerjes se procedures ne nje kohezgjatje te arsyeshme duke e detyruar organin public te ndermarre iniciativen e pershpejtimit te procesit te zgjidhjes te geshtjes paraprake.Per me teper, te dyja pikat i sherbejne si interesit individual te pales
per t'u informuar dhe mbeshtetur ne lidhje me kerkesen e nje geshtje paraprake, ashtu edhe interesit te te dyve: pales dhe publikut per nje perfundim te procedures ne teresi (pika 2 dhe 3)
Neni 66 z{...}het ne te gjitha fazat dhe hapat e nje procedure administrative, sa here qe ndeshet nje geshtje paraprake, qofte gjate procedures ne shkalle te pare, qofte gjate procedures se mjeteve juridike administrative. Neni 66 nuk z{...}het ne rastet e zbatimit te nenit 70 "vendimmarrja e perbashket" dhe neneve 74, 75 qe rregullojne "pikat e sherbimit me nje ndalese", edhe pse "nje organ tjeter publik" eshte i perfshire ne procedure
Formulimi i pikes 1 nenkupton, se pari, ekzistencen e nje procedure administrative, me tej percakton subjektin e normes, qe eshte organi publik kompetent per zhvillimin e kesaj procedure, dhe me ne fund percakton afatin brenda te cilit z{...}het norma.
Kjo e fundit specifikohet nepermjet konceptit te procedures administrates administrative (pika 3, e nenit 3), domethene fillimi i saj (shih nenin 41) dhe perfundimi (shih neni 90).
Zgjidhja e geshtjes eshte "vendimmarrja perfundimtare per geshtjen" te permendur ne piken 1, te nenit 90, domethene nxjerrja e nje akti administrate, lidhja e nje kontrate administrative ose kryerja e ndonje veprimi tjeter administrativ sipas regjimit te se drejtes administrative

(nenet 126, 127) lidhur me proceduren ne vazhdim.
Me termin "zgjidhje", ligjvenesi percakton momentin, kur pasiguria e shkaktuar nga geshtja paraprake mbaron.Per kete qellim, ligjvenesi perdor ne fund te pikes 1 frazen "deri ne marrjen e nje vendimi te formes te prere per geshtjen paraprake". Me kete fraze ku perdoret koncepti "vendim perfundimtar" pika 1 i referohet nenit 451 te Kodit te Procedures Civile.
Nga kjo rrjedh se per procedurat gjyqesore ne pergjithesi, qofte per procedurat civile nepermjet zbatimit te drejtperdrejte te nenit 451 te Kodit te Procedures Civile ose per gdo procedure tjeter gjyqesore nepermjet zbatimit analog te kesaj norme, geshtja paraprake zgjidhet ne momentin kur vendimi gjyqesor merr forme te prere.
Pika 3 rregullon rastet ne te cilat geshtja paraprake mund te zgjidhet me nje procedure administrative, e cila mund te fillohet vetem kryesisht nga nje organ tjeter publik (kompetent per te vendosur mbi geshtjen paraprake). Gjithashtu, ne kete rast, organi publik qe zhvillon proceduren e pezulluar duhet te kete rol aktiv te pasqyruar tek detyrimi (formulimi detyrues "kerkon fillimin") qe te kerkoje shprehimisht nga organi tjeter kompetent qe te filloje proceduren. Gjithashtu, duhet te theksohet se termi "kerkon" ne piken 3 duhet te lexohet ne menyre te ngushte, pasi nuk eshte kerkim ne kuptimin e nje kerkese fillestare, paraqitja e se cilesreshte ne gjendje te filloje per shkak te ligjit nje procedure por me teper nje "rekomandim" zyrtar ose "reference ndaj situates ligjore" per te filluar nje procedure, e cila, nga ana e saj, mund te fillohet vetem kryesisht nga organi kompetent publik ne baze te nenit 41.
Nga sa me siper rezulton se rasti I pezullimit te procedures administrative nese eshte duke u zhvilluar nje gjykim qe mund te kete ndikim edhe ne kete procedure administrative organi administrative ka te drejten ta pezulloje ate.Rasti I pezullimit te procedures administrative eshte nje rast klasik I pezullimit dhe per me teper mbeshtetet edhe ne nenin 36 /2 te K.Pr.Civile ndalon kryerjen e gfaredolloj procedure administrative nderkohe qe ajo eshte duke u shqyrtuar nga Gjykata:
*" Asnje institucion tjeter nuk ka te drejte te pranoje per shqyrtim nje mosmarreveshje civile qe eshte duke u gjykuar nga gjykata."*
Ne rastin konkret Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Tirane ka marre ne shqyrtim kerkese padine e paraqitur nga Shoqeria {...}me objekt:
*" Shfuqizimin e vendimit nr 934/9 prot date 01.09.20171 Bordit te Apelimit te DPPI duke vendosur*
*vijimin e rregjistrimit si marke tregtare te aplikacionit me nr kerkese AL/T/2016 934 date 12.12.2016"*
Ne kete padi, shoqeria{...} shpk e ka kundershtuar dokumentin e prioritetit te Klik EKSPO GROUP TIRANE", sepse ne vleresimin e tij nuk ka vlere ligjore per te percaktuar prioritetin, per shkak se panairi nuk ploteson kriteret e nenit 148 te ligjit.
Me vendimin nr 785 date 05.03.2018 Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Tirane ka vendosur:
*"Pranimin e kerkese padise.*
*Konstatimin e pavlefshmerise absolute te vendimit nr 934/9 date 01.09.2017 te Bodir te Apelimit prane Drejtorise se Pergjithshme te pronesise industriale.*
*Detyrimin e pales se paditur Drejtoria e Pergjithshme e Pronesise Industriale te vijoje proceduren e rregjistrimit e markes me nr AL/T/2016/934 ne emer te shoqerise {...}........................................................................................................."*
Kunder ketij vendimi eshte paraqitur ankim dhe geshtja eshte rregjistruar per gjykim perpara Gjykates Administrative te Apelit Tirane ne pritje te gjykimit.
Ne lidhje me pretendimin per te drejten e prioritetit Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Tirane ne vendimin nr 785 date 05.03.2018 ka arsyetuar se:
*".paditesi (Shoqeria {...}) pretendon se e drejta e prioritetit lidhet me paraqitjen e mallit me shenjat dalluese ne nje ekspozitenderkombetare zyrtare ose te njohur zyrtarisht nga shteti qe eshte anetar i Konventes se Parisit. Sipas pretendimeve te paditesit, neni 148 i ligjit 9947 parashikon kater kushte kumulative te rendesishme qe duhet te konkurrojne se bashku per te fituar te drejten per prioritet.*
*Ky pretendim I paditesit eshte i pambeshtetur ne ligj dhe ne intepretim te gabuar te ligjit material .Per me teper edhe kushtet e renditura nga paditesi per vleresimin e te drejtes se prioritetit jane pasqyruar ne interpretim teresisht te gabuar te nenit 148 te ligjit 9947. Asnje nga keto kushte nuk qendron dhe nuk eshte i nevojshem te vertetohet ne menyre qe nje marke tregtare te gezoje te drejten e prioritet Giithashtu referimi i vazhdueshem ne nenin 4 te Konventes se Parisit nga ana e paditeslt eshte teresisht i gabuar. Neni 4 i Konventes se Parisit z{...}het vetem ne ato raste ku e drejta e prioritetit kerkohet brenda nje periudhe 6-mujore bazuar ne nje aplikim marke te meparshem qe mund te jete depozituar nga aplikanti ne njerin prej vendeve te Unionit (neni 147 i ligjit 9947) dhe jo mbi bazen e nje ekspozim, te mallrave. Ne rastin e markave {...}, e drejta e prioritetit eshte kerkuar bazuar mbi ekspozimin mallrave me te njejten shenje ne nje ekspozite te njohur ne Republiken e Shqiperise*
*Krahas sa me siper, vlefshmeria dhe legjitimiteti i te drejtes se prioritetit nuk mund te shqyrtohet nga Bordi i Apelimit apo gjykata duke qene se eshte jashte objekti gjykimit administrativ.E drejta per prioritet e markave tregtare ekzaminohet dhe vleresohet paraprakisht nga Sektori i Markave tregtare si njesia pergjegjese dhe kompetente per ekzaminimin e aplikimeve per regjistrim marke. Pra, e drejta e Pnoritetit I perket nje tjeter procedure administrative dhe miratohet nepermjet nxjerrjes se nje akti Administrativ te vegante. Ne kuptim te Kodit te Procedurave Administrative, Sektori I Markave Tregtare eshte njesia pergjegjese per kete tip procedure admimstrative, ndersa Bordi i Apelimit ka per detyre te shqyrtoje anen formale dhe materiale te kerkeses per kundershtim te regjistrimit te markes.*
*Ne perfundim te procedures se ekzaminimit te aplikimit per marke, dhe ne rast se aplikimi permban elementet ligjore te parashikuar ne ligj e ne rregulloren e markave , DPPI-ja nxjerr aktin administrativ perkates (deshmine e depozitimit te markes) ku pasqyrohen te gjithe te dhenat e markes. Me tej, DPPI-ja ben publikimm e markes ne buletinin zyrtar te Pronesise Industriale (Marka tregtare dhe disenjo) duke i lejuar dhe mundesuar gdo personi te interesuar te kerkoje mosregjistrimin e markes brenda nje periudhe 3-mujore duke filluar nga data e publikimit te saj.*
*Nje e drejte e tille nuk eshte ushtruar nga ana e paditesit, i cili kishte te gjithe mundesite ligjore per te kundershtuar te drejten e prioritetit te markave {...} te personit te trete. Ne kete konktest, eshte teresisht e pakuptimte dhe jashte objektit te procedures administrative ne fjale qe e drejta e prioritetit te markave {...} te personit te trete te kundershtohet apo te vihet ne dyshim gjate nje tipi tjeter procedure Administrtaive sig eshte kerkesa per kundershtimin e regjistrimit te markes {...} (AL/T/2016/934) te aplikuar nga paditesi. Perfundimisht, data a prioritetit e nje marke tregtare konsiderohet data e percaktuar nga Sektori i Markave Tregtare gjate procedures se ekzamnimit dhe leshimit te deshmise se depozitimit. Ne gdo rast, Bordi i Apelimit nuk ka asnje tager te veje ne dyshim daten e prioritetit te markes se njohur nga Sektori I Ekzammimit Markave tregtare.*
*Per me teper sig u permend edhe me siper, Bordi i Apelimit nuk mund te vleresoje apo te shavrtoje daten e prioritetit te nje marke ne kushtet kur gjendemi perpara procedures se te regjistrimit te nje marke tjeter. Gjate shqyrtimit te procedures se kundershtimit te nje marke, Bordi i Apeiimit mbeshtetet vetem ne analizimin e anes formaie dhe materiale te kundershtimit ndaj regjistrimit te markes se kontestuar. Pas perfundimit te procedures se ekzaminimit te aplikimit per marke, te gjithe te dhenat e aplikimit publikohen ne Buletinin e Pronesise Industriale dhe nuk mund te shqyrtohen apo te rivleresohen serish nga Bordi i Apelimit ne nje procedure kundershtimi ndaj nje marke tjeter.*
*Si rrjedhoje te gjithe pretendimet e paditesit ne lidhje me mosekzistencen apo mosnjohjen e te drejtes se prirotetit pe rmarkat {...} te personit te trete nuk kane vlere ne lidhje me objektin e shqyrtimit administrative dhe nuk mund te merren ne shqyrtim nga gjykata. Pra si perfundim cdo argument I perdorur nga pala paditese ne lidhje me te drejten prioritare te markave {...} te personit te trete nuk mund te ngrihen dhe as te shqyrtohen perpara Bordit te Apelimit te DPPI-se apo gjykates.*
*Bazuar ne nenin 37 (1) te ligjit 49/2012,gjykata shqyrton ligjshmerine e veprimit administrative qe kundershtohet ne baze te provave te paraqitura nga palet dhe te situates ligjore dhe faktike qe ekzistonte ne kohen e kryerjes se veprimit konkret administrative:*

*Gjithesesi, theksojme se e drejta perprioritet e markave tregtare {...} te personit te trete eshte njohur ne perputhje te plote me ligjin 9947 dhe VKM-ne nr. 1706 Rrequllorja e markave"). Ne intepretim te gabuar te ligjit material, paditesi pretend on se drejta e prioritetit lidhet me paraqitjen e mallit me shenjat dalluese ne nje ,ekspozite nderkombetare zyrtare ose te njohur zyrtarisht nga shteti qe eshte anetar i Konventes se Parisit.*
*Nie parashikim ligjor i tille nuk gjendet as i shprehur, dhe as i nenkuptuar, ne asnje dispozite ligjore te ligjit 9947 apo rregullores se markave. Perkundrazi, neni 148 I ligjit nr 9947 dhe rregullat 4.1 e 4.4 te Kreut II te VKM-se nr. 1706, parashikojne shprehimisht dhe konkretisht te drejten e prioritetit bazuar ne ekspozimin e mallrave dhe/ose sherbimeve me nje shenje te caktuar Nga intepretimi literal i dispozitave ligjore te siperpermendura, rezulton fare qarte se e drejta per prioritet i njihet gdo personi qe ka ekspozuar mallrat dhe/ose sherbimet me nje shenje te caktuar ne nie ekspozite te njohur ne Republiken e Shqipense ose ne nje shtet tjeter qe eshte anetar i Koventes se Parisit. Pra, neni 148 i ligjit 9947, nuk permban ne asnje germe te tij faktin se kjo ekspozite duhet te jete ekspozite nderkombetare zyrtare apo e njohur zyrtarisht nga Organizata/Byroja e Panaireve Nderkombetare. Pretendimi i paditesit se vetem Organizata/Byroja e Panaireve Nderkombetare ka te drejte te mbikqyre ekspozitat nderkombetare ne lidhje me prioritetet, eshte teresisht i gabuar dhe i pambeshtetur ne ligj. Paditesi nuk ka cituar asnje dispoziteliigjore konkrete se ku parashikohet nje fakt i tille. Perkufizimi te cilit i referohet paditesi mund te z{...}het per shembull ne rastin e nje aplikimi nderkombetar per regjistrim marke, ku e drejta per prioritet lidhet me nje ekspozite nderkombetare zyrtare apo te njohur zyrtarisht jashte territorit je Republikes se Shqiperise sipas kuptimit te Konventes "Per ekspozitat nderkombetare Ne asnje rast, askush nuk mund te pretendoje qe ekspozimi i mallrave dhe/ose sherbimeve ne nje panair apo ekspozite te zhvilluar ose te njohur ne territorin e Republikes se Shqiperise, nuk mund te sherbeje si baze per njohjen e te drejtes se prioritetit. Koncepti dhe mbrojtja e markes tregtare lidhet ngushtesisht dhe ekskluzivisht vetem me territorin perkates ne te cilin marka regjistrohet dhe perdoret.*
*Ne kete kuptim, mjafton qe te vertetohet ekspozimi i mallrave ne nje ekspozite te njohur ne Republiken e Shqiperise ne menyre qe aplikimi per regjistrimin e ekspozimit te ketyre mallrave si date prioriteti. Nje qendrim ligjor i tille eshte mbajtur parasysh edhe nga legjislatori shqiptar, i cili ne nenin 148 te Ligjit 9947 e kushtezon njohjen e dates se prioritetit me ekspozimin e mallrave ne nje ekspozite te njohur Republiken e Shqiperise dhe jo ne nje ekspozite nderkombetare zyrtare apo te njohur zyrtarisht nga Organizata/Byroja e Panaireve Nderkombetare.*
*Gjithashtu, VKM-ja nr. 1706 qe percakton rregullat dhe procedurat e hollesishme per regjistrimin e markave tregtare, parashikon qartesisht faktin se aplikanti i markes duhet te depozitoje brenda nje periudhe 3-mujore nga data e aplikimit te tij certifikaten e leshuar nga autoritetet kompetente te ekspozites, ku jane paraqitur mallrat dhe /ose sherbimet ne baze te nenit 148 te ligjit. Nje dokument ligjor i tille eshte dorezuar rregullisht nga personi i trete prane DPPI-se ne momentin e aplikimit te markave {...} (AL-T-2017-72 dhe AL-T-2017-71).* ***Ne kete kuptim, dokumenti-vertetimi nr.prot. 38, date 23/01/2017 i leshuar nga autoritetet kompetente te ekspozites ne formen dhe menyren e kerkuar nga ligji, provon qartesisht ekspozimin e produkteve alkoolike brandy me shenjen {…} ne datat 24.11.2016 - 28.11.2016 ne nje ekspozite te njohur ne Republiken e Shqiperise: Klik Ekspo Klik.***
*Se fundmi, perkufizimi "ekspozite nderkombetare zyrtare apo e njohur zyrtarisht" permendet vetem ne nenin 4(3) te ligjit 9947. Nje term i tille nuk ndeshet me ne asnje dispozite ligjore apo pjese te ligjit lidhur me markat tregtare. Madje, nje term i tille nuk permendet dhe nuk referohet ne asnje moment as ne Rregulloren e markave. Ky term permendet serish vetem ne rregullen 2.1 te VKM-se nr. 1707, date 29.12.2008 ("Rregullorja per leshimin e patentave per shpikje dhe modele perdorimi), ku jepen perkufizimet per termat e ligjit 9947 ne lidhje me patentat e shpikjeve dhe modelet e perdorimit."*
Pretendimet e Shoqerise {...}ne procedurat administrative perpara Pales se paditur perfshijne si shkak kundershtues argumentin se:
"***pala e kundershtuar*** *per te drejtat e meparshme mbeshtetet ne daten e prioritetit te fituar ne baze te nenit 148 te ligjit, nepermjet ekspozimit te te njejtave marka ne Klik Ekspo Group Tirane nga ku eshte leshuar dhe dokumenti vertetues i pjesmarrjes ne panair."* Duke qene se ky pretendim eshte shqyrtuar ne kete gjykim vendimi per te cilin ende nuk ka marre forme te prere Gjykata gmon se me te drejte eshte pezulluar procedura administrative.Ne kete menyre organi administrative shmang nje vendimarrje ne potencial kontradiktore me vendimin e Gjykates qe ne kete rast do te shkaktonte komplikim te procedures administrative.
Nga sa me siper Gjykata cmon se kerkese padia rezulton e pambeshtetur ne ligj dhe per pasoje duhet te rrezohet.

## Per keto arsye

Baza Ligjore:
Gjykata bazuar ne nenet 126, te Kodit te Procedures Civile,nenit 40 te ligjit nr 49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative"

## VENDOSI:

Vendosi:
Rrezimin e kerkese padise me nr 2080 Akti me pale paditese shoqeria {...}.
2.Shpenzimet gjyqesore si jane kryer.
3.Kunder ketij vendimi lejohet ankim Brenda 15 diteve ne Gjykaten Administrative te Apelit Tirane.Ky afat fillon te llogaritet nga e nesermja e komunikimit te vendimit.
U shpall sot neTirane ne date 12.10.2020 !

## SHPENZIMET GJYQESORE

| | |
|---|---|
| Kerkesepadia | o |
| Taksa Gjyqesore | 0 |
| Noterizime | o |
| Njoftime | o |
| Akt ekspertimi | o |
| Avokat | o |

**Gjithsej** 0

GJYQTAR:

{...}